



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE I MINIERAVE  
DEPARTAMENTI I BURIMEVE TË ENERGJISË



# PROVIMI FORMUES PËR DIPLOMËN BACHELOR

PROGRAMI PËR

Diplomën Bachelor: *Inxhinieri e Naftës dhe Gazit*

## GRUPI I PUNËS:

<i>Spiro Thodhorjani</i>	<i>(kryetar)</i>
<i>Nevton Kodhelaj</i>	<i>(anëtar)</i>
<i>Bardhosh Seitaj</i>	<i>(anëtar)</i>
<i>Esmeralda Zeqo</i>	<i>(anëtar)</i>
<i>Nevina Polo</i>	<i>(anëtar)</i>

DEPARTAMENTI I BURIMEVE TË ENERGJISË

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2375246/5, web: [www.fgjm.edu.al](http://www.fgjm.edu.al); e-mail: departamentiburimeveenergji@fgjm.edu.al

# PROVIMI FORMUES PËR DIPLOMËN BACHELOR

## PROGRAMI PËR:

Diplomën Bachelor: *Inxhinieri e Naftës dhe Gazit*

### Qëllimi i Programit

Të bëjë vlerësimin përfundimtar të studentit që ka përfunduar tre vite akademike të studimit në diplomën Bachelor, *Inxhinieri e Naftës dhe Gazit*, pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës.

### Kërkesa për tu paraqitur në këtë provim

Studenti duhet të ketë fituar 175 kredite (ECTS) gjatë studimeve në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave në përputhje me planin mësimor të Diplomës përkatëse Bachelor.

### Literatura për provim

#### I. MODULI I

1. *Fluidet teknologjike në shpimin e puseve*
2. *Inxhinieria e shpimit të puseve 1*

#### II. MODULI II

1. *Mekanika e fluideve nëntokësorë 1*
2. *Inxhinieria e rezervuarit 1*

#### III. MODULI III

1. *Inxhinieria e nxjerrjes të naftës dhe gazit 1*
2. *Pajisje dhe matje*

# PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

## MODULI I

### 1. Fluidet teknologjike në shpimin e puseve

*Prof. Dr. Riza Aleti*

#### **Programi i lëndës:**

Funksionet kryesore të fluideve të shpimit, pastrimi i shllamit, mbajtja pezull e shllamit dhe e rënduesave, kontrolli dhe balancimi i presioneve, izolimi i fluideve të formacioneve, ftohja dhe lubrifikimi i daltës dhe tubave të shpimit, lehtësimi i peshës së instrumentit të shpimit dhe tubave të rrethimit, kontrolli i korrozionit, mbrojtja e formacioneve, sigurimi i informacionit për pusin. Vetitë e fluideve të shpimit, densiteti, vetitë e rrjedhjes, reologjia, filtrimi, vetitë fizike, vetitë kimike, përmbajtja e fazave, pH-shi, termoqëndrueshmëria. Kompozimi i fluideve të shpimit, kimia e argjilave, ngarkesa sipërfaqësore, grupet e mineraleve argjilore, argjilat në fluidet e shpimit, argjilat e formacioneve, argjilat në zonën produktive, materialet rënduese, reagentët kimikë, kontaminimi kimik, lëngjet e shpimit me bazë ujë, lëngjet e shpimit me bazë naftë. Përpunimi kimik i fluideve të shpimit, reagentët kimikë, polimerët, kimia e polimerëve, tipet e polimerëve, lëngjet e shpimit inhibuese, lëngjet kalçiumore, sistemet me lignosulfonate, lëngjet kripore, lëngjet me klorur kaliumi, bashkëveprimi lëng-shkëmb, lëngjet e shpimit si burim informacioni.

#### **Pyetjet për provim:**

1. Funksionet teknologjike të lëngut larës. Lëngu larës si burim informacioni.
2. Parametrat rheologjikë të lëngut larës. Paraqitja grafike e varësisë së parametrave reologjikë nga gradient i shpejtësisë. Emulsionet, tipet e emulsioneve, përdorimi i tyre si lëng larës.
3. Filtrimi i lëngut larës. Faktorët që ndikojnë në filtrimin e lëngut larës. Suspensioni i çimentos. Përgatitja dhe karakteristikat e suspensionit të çimentos.
4. Parametrat kimikë të lëngut larës. Përcaktimi i përmbajtjes së joneve kalcium (Ca) dhe klor (Cl). Llogaritja e presioneve hidrostatike gjatë etapave të çimentimit të pusit.
5. Modelet rheologjike të fluideve teknologjike. Paraqitja grafo-analitike e modeleve reologjike. Llogaritjet për ngjitjen e tubave të shpimit në faqet e pusit nga presioni diferencial.
6. Si përcaktohet densiteti i lëngut larës për shpimin e pusit? Rëndimi dhe hollimi i lëngut larës. Llogaritja e sasisë së rënduesit për rëndimin e lëngut larës me densitet të caktuar.
7. Sa është vlera e ndryshimit të presionit hidrostatik midis hapësirës unazore (kezingut) dhe hapësirës qendrore (tubingut) nëqoftëse hapësirë unazore ka 2% shllam me densitet  $2 \text{ gr/cm}^3$ ? Kriteret për zgjedhjen e debitit të lëngut larës. Llogaritjet e debitit të lëngut larës.
8. Si llogaritet përmbajtja e bentonitës në argjilën me të cilën është përgatitur lëngu larës duke ditur përmbajtjen e bentonitës në lëngun larës? Cikli i qarkullimit të lëngut larës në pus. Llogaritja e kohës së një cikli.
9. Tipat dhe llojet e lëngjeve larës. Llogaritja e densitetit të lëngut larës për shpimin e një shtrese gazi.
10. Mekanizmi i veprimit të reagentëve kimikë. Llogaritja e densitetit të lëngut larës për shpimin e një shtrese me gradient presioni të dhënë.

**Programi i lëndës:**

Vetitë fizike dhe mekanike të shkëmbinjve. Parimi dhe mënyra e përcaktimit të vetive mekanike të shkëmbinjve. Ligjet e shkatërrimit të shkëmbinjve. Dukuritë fizike që ndikojnë në ndryshimin e vetive mekanike të shkëmbinjve. Klasifikimi IADC i daltave të shpimit. Llojet e ndryshme të instrumentëve shkëmbshkatërrues. Vecoritë ndërtimore të tyre; instrumentët pa elementë të lëvizshëm si ato me fletë, me diamant dhe PDC. Instrumentët me elementë të lëvizshëm (daltat me rula). Kolona e shpimit, pjesët përbërëse të saj. Karakteristikat fizike dhe mekanike të tubave të shpimit. Mënyra e llogaritjes dhe e kontrollit të kolonës së shpimit. Treguesit e procesit të shpimit; treguesit cilësorë dhe sasiorë. Treguesit teknikë dhe ato tekniko-ekonomikë. Faktorët që ndikojnë në treguesit e shpimit të një pusi; gjeologjikë, psikologjikë, teknikë dhe ato teknologjikë. Konstruksioni i puseve, përbërja e tyre, veçoritë. Lloji i kolonave të rrethimit. Tubat e kolonave të rrethimit, mënyra e prodhimit të tyre. Karakteristikat fizike dhe mekanike të tubave të rrethimit. Hartimi i konstruksionit të një pusi. Motorët ballorë në shpimin e puseve.

**Pyetjet për provim:**

1. Fortësia si veti mekanike e shkëmbinjve, llojet, ndryshimi midis tyre dhe çfarë përcakton secila prej tyre.
2. Ligjet e shkatërrimit të shkëmbinjve (Ritinger dhe Kirpicov), ndryshimet, ngjashmëritë? Për çfarë shërbejnë në praktikën e shpimit?
3. Regjimi sipërfaqësor i shkatërrimit të shkëmbinjve në ballë të pusit sipas mënyrës mekanike të shpimit.
4. Çfarë është matrica dhe çfarë kërkesash duhet të plotësojë materiali i saj në daltat me diamantë.
5. Kushinetat si pjesë përbërëse e daltave me rula, llojet, funksionet, materialet përbërëse.
6. Materialet përbërës të dhëmbëve me rula në daltat me dhëmbë të prerë dhe me dhëmbë të vendosur. Karakteristikat e dhëmbëve.
7. Tubat rëndues si pjesë përbërëse e kolonës së shpimit, funksionet, llojet dhe kriteret e zgjedhjes së diametrit të tyre.
8. Sforcimet në përkuqe të kolonës së shpimit: shkaqet, vendi (seksioni) më i rrezikshëm, masat për zvogëlimin e tyre.
9. Çfarë është konstruksioni i një pusi? Bëni një skemë konkretizuese të tij! Cilët janë funksionet e kolonës së shfrytëzimit në konstruksion?
10. Interpretoni treguesin e shpejtësisë ekonomike të shpimit.

**MODULI II**

**1. Mekanika e fluideve nëntokësorë 1**

**M.Sc. Drilona Sauli**

**Programi i lëndës:**

Mekanika e fluideve pjesa e parë trajton problemet e mëposhtme: Mekanika e fluideve në mjediset poroze dhe zhvillimi i saj në vendin tonë. Vetitë fizike të shkëmbinjve kolektorë. Përbërja kokrizore, poroziteti, përshkueshmëria, sipërfaqja specifike, marrëdhënia porozitet-përshkueshmëri. Veçoritë kolektore të shkëmbinjve me çarje, poroziteti, përshkueshmëria, ngopshmëria e shkëmbit me naftë, ujë dhe gaz. Vetitë e fluidit të shtresës. Gazi, Nafta dhe Uji, vetitë e tyre në kushtet e sipërfaqes. Gazet natyrore, vetitë fizike të gazeve natyrore. Nafta, përbërja kimike e naftës, dendësia e naftës, viskoziteti i naftës, gjendja e ujërave në shtratimet e naftës. Njohuri themelore rreth shndërrimeve fazore në sistemet e hidrokarbureve. Gjendja fizike e naftës, gazit dhe

ujit në shtresë, diagrama PV e PT në sistemet dyjore. Shndërrimet fazore gaz-naftë. Konstantet e ekuilibrit fazor. Ekuacionet e përqëndrimit. Vetitë fizike të fluideve të shtresës në kushtet e shtresës. Vetitë fizike të naftës në kushtet e shtresës, tretshmëria e gazeve në naftë. Presioni i ngopjes. Koeficienti vëllimor i naftës. Dendësia, viskoziteti, ngjeshmëria e naftës së shtresës. Vetitë reologjike të naftës së shtresës. Klasifikimi i lëngjeve sipas vetive reologjike. Nafta asfalteno-rrëshinore dhe vetitë reologjike. Vetitë reologjike të naftave asfalteno-rrëshinore. Vetitë fizike të ujërave të shtresës në kushtet e shtresës. Studimi i vetive të naftave të shtresës. Studimi laboratorik i fluideve të rezervuarit, testet e aplikuara. Korigjimi i të dhënave. Vetitë Fiziko-Kimike të sistemit Naftë-Gaz-Ujë-Shkëmb. Vetitë sipërfaqësoro- molekulare, polariteti i molekulave, ndajthithja, tensioni sipërfaqësor, lagshmëria, presioni kapilar dhe marrëdhënia e tij me ngopshmërinë, metodat e matjes së presionit kapilar dhe përcaktimi i strukturës së hapësirës poroze të shkëmbinjëve. Bazat fizike të procesit të shtytjes së naftës me ujë dhe me gaz.

#### ***Pyetjet për provim:***

1. Vetitë fizike të shkëmbinjve kolektorë, sipërfaqja specifike.
2. Marrëdhënia porozitet-përshkueshmëri.
3. Njohuri themelore rreth shndërrimeve fazore në sistemet e hidrokarbureve.
4. Diagrama PV e diagrama PT në sistemet dyjore.
5. Shndërrimet fazore gaz-naftë.
6. Konstantet e ekuilibrit fazor. Ekuacionet e përqëndrimit.
7. Vetitë reologjike të naftës së shtresës. Klasifikimi i lëngjeve sipas vetive reologjike.
8. Vetitë sipërfaqësoro-molekulare, polariteti i molekulave, ndajthithja, tensioni sipërfaqësor.
9. Lagshmëria, presioni kapilar dhe marrëdhënia e tij me ngopshmërinë,
10. Metodat e matjes së presionit kapilar dhe përcaktimi i strukturës së hapësirës poroze të shkëmbinjve.

#### ***2. Inxhinieria e rezervuarit 1***

***Prof. Dr. Nevton Kodhelaj***

#### ***Programi i lëndës:***

Analogjia elektrohodinamike. Konturi fiktiv i ushqimit. Konturi fiktiv i ushqimit në shtresat brezore. Konturi fiktiv i ushqimit në shtresat rrethore. Debiti i puseve dhe radhëve sipas analogjisë elektrohodinamike. Treguesit e përpunimit në shtresat brezore dhe rrethore. Përpunimi i shtratimeve të naftës dhe gazit me ujëra aktivë dyshemeje. Depresionet dhe debitet kritike. Konet e ujit. Faktori i përmbytjes, çarjet dhe roli i tyre në naftënxjerrje. Zhvendosja e naftës nga uji. Ngopshmëria në frontin e zhvendosjes. Faktori gravitacional, thithja kapilare, zgjerimi elastik, veçoritë, përcaktimi i naftënxjerrjes. Depresionet dhe debitet e shfrytëzimit të puseve. Debitet dhe depresionet kritike. Zhvendosja në kushte ndarjeje fazore. Zhvendosja në rezervuarë të shtresëzuar. Parashikimi i marrjes së naftës në regjimin e gazit të tretur dhe atë të ujërave aktivë. Ecuria e prodhimit të naftës në zgjerimin e gazit të tretur. Veçoritë e llogaritjes së rezervave dhe vlerësimi industrial i tyre në kolektorët me çarje. Koeficienti i nxjerrjes specifike të naftës. Varësia e koeficientit të naftënxjerrjes specifike nga shpejtësia e lëvizjes së kontaktit ujë-naftë. Zgjedhja e shpejtësive. Llogaritja e debitit të naftës, vëllimit të shkëmbit të shplarë të shkëmbit dhe e naftës që mbetet në shtresë për një pus. Filtrimi i pavendosur, rënia e presionit. Analiza e rënies. Analiza e lakoreve të rënies. Rënia eksponenciale,  $b=0$ . Rënia harmonike,  $b=1$ . Rënia hiperbolike,  $0 < b < 1$ .

#### ***Pyetjet për provim:***

1. Konturi pozitiv, negativ dhe ai fiktiv i ushqimit.

2. Llogaritja e rezistencave hidrodinamike për një rezervuar që shfrytëzohet me galeri brezore, sipas analogjisë elektro-hidrodinamike.
3. Llogaritja e rezistencave hidrodinamike për një rezervuar që shfrytëzohet me galeri rrethore sipas analogjisë elektro-hidrodinamike.
4. Me të dhëna sipas dëshirës (të merren të dhënat për 4 vite) të llogaritet koha e shfrytëzimit të një rezervuari i cili shrytëzohet me galeri rrethore sipas skemës analoge.
5. Me të dhëna sipas dëshirës (të merren të dhënat për 4 vite) të llogaritet koha e shfrytëzimit të një rezervuari i cili shrytëzohet me galeri brezore sipas skemës analoge.
6. Me të dhëna sipas dëshirës sipas modelit B-L-W të llogariten funksionet:  

$$k_{rn} = a_0 + a_1 S_n + a_2 S_n^2 + a_3 S_n^3 \text{ dhe } k_{ru} = b_0 + b_1 S_u + b_2 S_u^2$$
7. Sipas modelit B-L-W të llogaritet:  

$$x = \frac{qt}{mF} \left( \frac{d\phi_u}{dS_u} \right)_{S_{uF}}$$
8. Llogaritja e rezervave të nxjerrshme në kolektorët me çarje sipas koeficientit të naftënxjerrjes specifike.
9. Llogaritja e debiteve të puseve sipas koeficientit të naftënxjerrjes specifike; varianti me shpejtësi konstante.
10. Analiza e rënies, funksioni i rënies për rënie harmonike.

### MODULI III

---

#### 1. Inxhinieria e nxjerrjes të naftës dhe gazit 1

*Dr. Dulian Zeqiraj*

##### **Programi i lëndës:**

Trajtimi i lëvizjes së fluidit pranë zonës pranëfundore dhe nëpër trungun e pusit duke përdorur një aparat të pasur matematik të argumentuar me shembuj konkretë, gjithashtu trajtohet gjerësisht edhe lëvizja e fluidit në puset horizontale, teknologji relativisht e re që ka filluar të zbatohet me sukses edhe në vendin tonë. Në kapitujt në vijim trajtohen metodat e shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe gazkondensatit, shfrytëzimi me fontanim natyror dhe artificial, shfrytëzimi me pompa thellësie, si dhe remonti nëntokësor. Më tej jepen disa njohuri bazë për rezervuarët e naftës dhe gazit dhe për vetite e fluideve të shkëmbinjve kolektorë si: kurthet, për klasifikimin e hidrokarbureve në përgjithësi dhe për naftat në veçanti, për gjendjet një, dy, tre dhe shumëfazore të shoqëruara me shembuj konkretë llogaritjesh. Gjithashtu edhe studimi hidrodinamik zë një pjesë të rëndësishme, ku përfshihen thuajse të gjitha metodat e studimit, me regjime të vendosura dhe të pavendosura për të gjitha rastet që paraqiten, në përputhje me llojin e shtratimit. Shfrytëzimi i puseve horizontale zë një vend të veçantë ku është për tu theksuar se paraqitet për herë të parë në një tekst të tillë, dhe ilustron me shembuj konkretë të marrë edhe nga përvoja e vendeve të tjera.

##### **Pyetjet për provim:**

1. Shfrytëzimi i puseve të naftës me erupsion natyror. Kushtet e erruimit natyror. Periudha e fontanimit.
2. Projektimi i parametrave të ngritësit. Kriteret e përcaktimit të parametrave të ngritësit.
3. Shfrytëzimi i puseve të naftës me pompa thellësie. Klasifikimi i pompave të thellësisë.
4. Formoni një kolonë purtekash të përbërë nga purteka me gjatësi 7.62 m dhe me diametër 52.4 mm, 22.2 mm dhe 19.0 mm përkatësisht. Diametri i pistonit  $d_p = 44.5\text{mm}$ ,  $L = 1500\text{m}$ ,  $\gamma_1 = 8826\text{ N/m}$ ,  $\delta = 0$ .

5. Shfrytëzimi i puseve me pompa thellësie pa purteka. Pompat me burmë.
6. Shfrytëzimi i puseve të gazit. Karakteristikat e regjimeve të filtrimit. Parimi i superpozimit.
7. Shfrytëzimi i puseve të gazkondensatit. Studimi i puseve. Përgatitja e pusit. Probleme konkretë nga shfrytëzimi i puseve.
8. Remonti nëntokësor i puseve të naftës dhe gazit. Remonti i zakonshëm. Remonti kapital.
9. Studimi hidrodinamik i puseve. Llojet e studimit të tyre. Ilustrimi grafik. Marrja e të dhënave.
10. Shfrytëzimi i puseve horizontale. Ardhja në to. Puset multilateralë dhe klasifikimi i tyre.

## **2. Pajisje dhe matje**

***Dr. Esmeralda Zeqo***

### ***Programi i lëndës:***

Sondat e shpimit dhe të shfrytëzimit. Parametrat teknike kryesorë të tyre: aftësia ngritëse, prurja dhe presioni i pompave të lëngut larës, fuqia instaluese për hallkat kryesore të sondës. Ngarkesat që veprojnë në sondë. Kategoritë e ngarkesave statike dhe llogaritja e tyre. Kinematika dhe drejtimi i sondës. Probleme të kombinimit të lëvizjes kryesore dhe ndihmëse në hallkat e sondës. Probleme të përpunimit të një skeme kinematike. Sistemi i drejtimit pneumatik, elementët përbërës të tij. Kullat në industrinë e naftës. Kërkesat kryesore dhe konstruksioni i tyre. Elementët dhe nyjet përbërëse. Parametrat teknikë të kullave. Llojet e ngarkesave që veprojnë në kullë. Bazat metalike dhe kombinimi i ngarkesave. Sistemi i zhvendosjes vertikale dhe i ngritjes në sondë. Elementët përbërës të sistemit të zhvendosjes dhe konstruksioni i tyre. Ngarkesat që veprojnë në degën e litarit. Litarët e çelikut, konstruksioni i tyre. Probleme të llogaritjes së litarëve të çelikut. Instrumenti ndihmës në ulje-ngritje. Instrumenti ndihmës dhe mekanizmi i operacioneve të ulje-ngritjeve të kolonave të tubave dhe purtekave. Instrumenti ndihmës për mbërthim – zberthim instrumenti. Montimi i sondave. Konstruksioni i tyre. Thellësia e zhytjes dhe ngarkesa maksimale që vepron mbi bazament. Probleme të organizimit të punimeve për montim-çmontimin e sondave. Agregatët energjetikë. Përdorimi, tipet dhe karakteristikat teknike. Bashkëveprimi i agregatit të fuqisë me pompat për numër rrotullimesh konstante, si dhe për moment rrotullimi konstant. Karakteristikat e agregatit të fuqisë. Transmisionet hidrodinamike, parimi i punës dhe konstruksioni. Pompat. Llojet e tyre. Llogaritjet e fuqisë së pompave. Pajisjet për përgatitjen, pastrimin, rigjenerimin dhe qarkullimin e lëngut larës. Pajisjet për pastrimin, dezinfektimin e lëngut larës. Pajisje të nxjerrjes së mekanizuar të naftës. Kompresorët. Zgjedhja e kompresorëve në nxjerrjen e naftës. Impiantet në nxjerrjen e mekanizuar të naftës. Tipet e lëkundësve dhe ngarkesat që veprojnë në të. Impianti i shfrytëzimit me pompë thellësie. Matjet dhe metodika e matjeve. Gabimet e matjeve. Faktorët që ndikojnë në to. Aparaturat e matjeve: Matja e temperaturës, e presionit, e nivelit, e debitit, në sipërfaqe dhe në trungun apo fund të pusit. Sistemi i transmetimit të të dhënave në distancë. Aparatura të tjera të matjeve në industrinë e naftës dhe gazit.

### ***Pyetjet për provim:***

1. Cilat janë ngarkesat që veprojnë në sondën e shpimit. Zgjedhja e parametrave teknikë të saj. Cilët aparate përdoren për vlerësimin e këtyre ngarkesave?
2. Kullat. Elementët dhe nyjet përbërëse të tyre. Parametrat teknike të kullës dhe llojet e ngarkesave që veprojnë në kullë.
3. Sistemi i zhvendosjes vertikale. Përbërja. Ngarkesat që veprojnë në degët e litarët. Instrumentët ndihmës të sistemit ulje – ngritje.
4. Agregatët energjetikë, përdorimi i tyre. Tipet dhe karakteristikat teknike.
5. Flisni për treguesin e avancimit. Shpjegoni diagramën e avancimit.

6. Klasifikimi i nivelmatësve sipas mënyrës së matjes. Ç'është eholoti? Shpjegoni ehogramën e marrë gjatë një matjeje.
7. Debitmatësit. Klasifikimi. Debitmatësi më flutur.
8. Manometrat e thellësisë, qëllimi, klasifikimi. Manometri me membrane.
9. Kompresorët. Karakteristikat e tyre. Zgjedhja e tyre në nxjerrjen e naftës.
10. Ushtrim, pompat. Të llogaritet prurja teorike e pompës së thellësisë me diametër pistoni  $D_p=0.068\text{m}$ , që kryen  $n=10$  rrot/min dhe pika A kryen rrugën  $S_A=1.8\text{m}$ , kur koeficienti i dhënies së pompës është  $\alpha=0.8$ .

### PJESA PRAKTIKE

Referuar kapitujve të mësipërm të përmbajtjes së teorisë së provimit, në pjesën praktike do të përfshihen:

1. Përmbajtjet e seancave të ushtrimeve dhe zbatimeve që përkojnë me pjesën teorike të mësipërme.
2. Përmbajtjet e Projekteve të Kursit dhe Detyrave të Kursit të zhvilluara gjatë vitit akademik përkatës.
3. Përmbajtjet e temave të Punëve të Laboratorit të zhvilluara, që përkojnë me pjesën teorike të mësipërme.
4. Përmbajtjet e Praktikave të zhvilluara gjatë viteve të kësaj diplome.

### FORMA E PROVIMIT

Provimi zhvillohet me shkrim dhe korrigjohet nga Komisioni i Provimit i miratuar nga Dekani i Fakultetit. Brenda pesë ditëve Komisioni i Provimit afishon në vend të dukshëm pikët dhe notat e kandidatëve.

### VLERËSIMI I STUDENTËVE

Provimi i paraqitur në këtë program vlerësohet me 5 kredite (ECTS). Vlerësimi i studentëve do të bëhet me notë nga 1 (një) deri në 10 (dhjetë). Nota minimale për të patur vlerësim pozitiv do të jetë 5 (pesë). Nota vendoset në përputhje me pikët sipas tabelave të mëposhtme.

Tabela 1: Llogaritja e detajuar e pikëve sipas lëndëve

	Moduli I		Moduli II		Moduli III	
	<i>Fluidet teknologjike në shpimin e puseve</i>	<i>Inxhinieria e shpimit të puseve I</i>	<i>Mekanika e fluideve nëntokësorë I</i>	<i>Inxhinieria e rezervuarit I</i>	<i>Inxhinieria e nxjerrjes të naftës dhe gazit I</i>	<i>Pajisje dhe matje</i>
Intervali i vlerësimit të pikëve	1 deri 20	1 deri 20	1 deri 20	1 deri 20	1 deri 10	1 deri 10

**Pikët totale** = Pikët e Modullit 1 + Pikët e Modullit 2 + Pikët e Modullit 3.

**Notës 1 i korrespondojnë 10 pikë, ndërsa notës 10 i korrespondojnë 100 pikë.**

$$\text{VLERA E NOTËS} = \frac{\text{PIKËT TOTALE}}{10}$$

Tabela 2: Vlerësimi me notë sipas pikëve të fituara

PIKËT	90 < p ≤ 100	80 < p ≤ 90	70 < p ≤ 80	60 < p ≤ 70	50 < p ≤ 60	40 < p ≤ 50	≤ 40
NOTA	10	9	8	7	6	5	4

### **DEPARTAMENTI I BURIMEVE TË ENERGJISË**